



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	19-04-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKPMSTICK	2230/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.268/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2335/2021 të datës 16.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.690/2021 të datës 27.07.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër deklarimit/rregullimit të statusit të zyrtarit publik, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 19.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.690/2021 e datës 27.07.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr vendim për deklarimin/rregullimin e statusit të ankuesit.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë, që të ndërmerr veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimit siç përcaktohet në pikën dy (II).
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Ekonomisë, më datë 27.07.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër deklaratimit të statusit të zyrtarit publik i verifikuar nga Departamenti i Menaxhimit të Zyrtaresve Publik, me pretendimin se kjo formë e vendimmarrjes bie ndesh me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtaresve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.08.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë, ndërsa më datë 05.08.2021, Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 10.09.2021 përmes shkresës me numër protokolli 4562/2021 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, në mungesë të vendosjes nga Këshilli, ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 16.03.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.2335/2021, me të cilin ka anuluar Njoftimin e datës 10.09.2021 dhe ka detyruar Këshillin që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 27.07.2021 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3933/2021 të datës 27.07.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 01.06.2015 të ankuesit; Shkresën për konfirmimin e vazhdimit të marrëdhënies së punës e datës 05.05.2016; Formulari për vlerësimin e punës provuese i datës 06.04.2016; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Cicëron i datës 16.04.2015; E-mailin e datës 30.06.2021 nga \_\_\_\_\_ për ankuesin; E-mailin nga info.dmzp e datës 11.06.2021 për \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 14.7.2021 nga \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 12.07.2021 nga \_\_\_\_\_ E-mailin e datës 18.07.2021 nga ankuesi; Konkursin për Cicëron i datës 25.02.2014; Tabelën e deklaratimit të statusit të zyrtarit publikë; E-mailin e datës 03.03.2021 nga \_\_\_\_\_ Përgjigjen në ankesë e datës 05.08.2021 dhe Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.08.2021; Njoftimin e datës 10.09.2021 për ankuesin dhe Aktgjykimin A.nr.2335/2021 të datës 16.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi se është pjesërisht e bazuar ankesa e ankuesit **SEPSE:**



Nga administrimi i provave të lëndës, përkatësisht sipas Akt Emërimit të datës 01.06.2015, rezulton së ankuesi është i punësuar në pozitën *Cicëron*, në Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Memorialëve Trepça, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 11.06.2021 ka përcjell në Ministrinë e Ekonomisë listën e verifikimit të deklaramit të statusit të zyrtareve publikë për këtë institucion, ndërsa me datë 30.06.2021 Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë ka njoftuar ankuesin lidhur me deklaramin e statusit sipas DMZP-së gjegjësisht se statusi i pozitës *Cicëron* është vendosur nëpunës i shërbimit publik.

Ankuesi, bazuar në udhëzimin sipas njoftimit të datës 30.06.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër deklaramit të statusit të zyrtarit publik, me pretendimin se kjo formë e vendimmarrjes bie ndesh me Ligjin par Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklaramin e Statusit të Zyrtarëve Publikë. Me tej, thekson së deklarami i statusit të nëpunësit civil bëhet me vendim nga njësia përgjegjëse dhe së pozita e tij duhet të jetë nëpunës i shërbimit civil.

Lidhur me pretendimin ankimor se deklarami i statusit bëhet me vendim nga njësia përgjegjëse, Kolegji ju referua nenit 83 paragrafit 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët më të cilin është përcaktuar se: *Deklarami apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja ne fuqi e këtij ligji. Procedura e deklaramit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative. 17. Ndaj vendimit për deklaramin/rregullimin e statusit të punësimit mund të paraqitet ankesë, në pajtim me ligjin, në KPMSHC, si dhe nenit 5 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklaramin e Statusit të Zyrtarëve Publikë është përcaktuar që: Rregullimi i statusit bëhet me vendim nga njësia përgjegjëse dhe pastaj lëshohet apo ndryshohet kontrata e punës nga punëdhënësi, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë me rastin e verifikimit të statusit të ankuesit nga DMZP-ja, ka qenë e obliguar që lidhur me deklaramin e statusit të ankuesit të nxjerrë vendi në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Kështu që, pas konstatimit së ankuesit nuk i është lëshuar akt administrativ lidhur deklarami/rregullimin e statusit të zyrtarit publik, dhe meqenëse e drejta e ankesës është e lejuar vetëm kundër vendimit për deklaramin të statusit, Kolegji nuk u leshu në trajtimin e pretendimeve tjera ankimore.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën



paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A nr.268/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Behteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI,**

*Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

